




Rrjeti 23 është  
i financuar nga  
Bashkimi Evropian dhe  
nga Mbretëria e Holandës



**Kapitulli 23:**  
**Gjyqësori dhe të drejtat themelore**  
**- Përse është çelës i aderimit drejt**  
**BE-së?**

Kjo broshurë është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjeti 23” i financuar nga Bashkimi Evropian, të cilin e realizojnë Instituti për politikë evropiane - Shkup, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe Qendra për menaxhim me ndryshimet. “Rrjeti 23” i formuar përbëhet nga 11 organizata të cilat do të mbikëqyrin dhe vlerësojnë politikat që kanë të bëjnë me kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

Kjo broshurë informuese për nenin 23 si pjesë përbërëse e aktiviteteve të projektit ka për qëllim që të afrojë standardet demokratike evropiane deri tek qytetarët, ti njoftojë me obligimet të cilat dalin nga procesi i aderimit për këtë kapitull dhe të nxisë aktivitetet e sektorit civil.

## Përse kapitulli 23?

Negociatat për anëtarësim në BE zhvillohen sipas kapitujve. Në procesin vijues të aderimit ekzistojnë 35 kapituj të cilët mbulojnë pjesë të caktuara të acquis së Bashkimit Evropian.

Kapitulli “më i ri” - Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore u bënë kyçe për aderimin në BE, katalizatorë të procesit të aderimit. Me futjen e këtij kapitulli në vitin 2005, kriteret politike u futën në negociimet për anëtarësim në BE. Së bashku me Kapitullin 24- Drejtësia, liria dhe siguria, e përbëjnë aksin “sundimi i ligjit” i Strategjisë së Be-së për zgjerim dhe bazën e “qasjes së re” në negociatat për anëtarësim në BE.

Për çdo shtet i cili fillon negociatat për anëtarësim në BE këta janë kapitujt që hapen të parët, ndërsa mbyllen të fundit. Për ata të cilët nuk janë në negociim, përmbajtja e Kapitullit 23 bëhet kusht gjithnjë e më i rëndësishëm për përparimin e mëtuqeshëm në integrim me BE-në.

Qëllimi i qasjes së këtyllë të BE-së është që shtetet të jenë plotësisht të përgatitura për anëtarësim, me institucione të fuqishme të cilat do të garantojnë për demokracinë dhe sundimin e ligjit, si dhe pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.


## Përmbajtja e Kapitullit 23

Përmbajtja e Kapitullit 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore bazohet në Nenin 2 nga Marrëveshja për Bashkimin Evropian i cili thërret në parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Këto parime janë të përbashkëta për të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe njëkohësisht janë të obligueshme për vendet kandidatë për anëtarësim. Neni 3(2) nga Marrëveshja për Bashkimin Evropian dhe neni 67(1) nga Marrëveshja

për funksionimin e Bashkimit Evropian formojnë sferën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Politikat e BE-së në sferën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore kanë për qëllim që ta ruajnë dhe avancojnë Bashkimin në këto sfera.

Kapitulli 23 është i strukturuar në tre fusha të mëdha:

- Gjyqësori;
- Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit;
- Të drejtat themelore.



Njëra nga sfidat kyçe në harmonizimin me BE-në në Kapitullin 23 është që për pjesën më të madhe të përmbajtjes së kapitullit nuk ekzistojnë akte ligjore të BE-së edhe krahas asaj që BE gjithnjë e më shumë angazhohet në këto fusha. Në pjesën më të madhe, nuk ekzistojnë “modele” të unifikuara për harmonizim me BE-në në këtë kapitull, në veçanti në drejtim të vendosjes së institucioneve. Bëhet fjalë për standarde demokratike dhe praktikata më të mira të vendeve anëtare të BE-së, shpesh të formuluar përmes “të drejtës së butë” të Këshillit të Evropës, në dokumentet e Kombeve të bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Ato gjithnjë janë në zhvillim dhe avancim e sipër. Aq më tepër është e rëndësishme që institucionet kombëtare dhe të gjitha palët e prekura, i gjithë sektori civil të jenë të kyçur në krijimin dhe përcjelljen e politikave kombëtare në këtë fushë.

## Gjyqësori

- Sundimi i së drejtës dhe e drejta për gjykim të drejtë të cilat janë të vëna në nenin 6 nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe neni 47 nga Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian tregojnë se gjyqësori duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm. Shtetet duhet t'i largojnë ndikimet e jashtme mbi organet e gjyqësisë.
- Shteti i cili dëshiron që të bëhet anëtar i BE-së duhet të mundësojë kushte për një gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe të përgjegjshëm, profesional, kompetent dhe efikas.
- Në kuadër të Këshillit të Evropës janë sjellë më shumë rekomandime dhe dokumente të tjera të cilat kanë të bëjnë me pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit.

## Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit

- Vendet anëtare të BE-së duhet të sigurojnë luftë efikase kundër korrupsionit i cili përfaqëson kërcënim serioz të stabilitetit të institucioneve demokratike dhe sundimit të së drejtës. Neni 83(1) nga Marrëveshja e funksionimit të Bashkimit Evropian e konfirmon kompetencën e Bashkimit për të vërtetuar rregulla minimale për definimin e akteve penale dhe sanksioneve nga fusha e korrupsionit.<sup>1</sup> Shtetet të cilat janë duke u aderuar duhet të sigurojnë edhe realizimin e marrëveshjeve ndërkombëtare kyçe nga kjo sferë.


Krahas kornizës ligjore dhe institucionale, BE insiston në funksionimin praktik të saj edhe dosje të lëndëve të cilat dëshmojnë përkushtimin në luftën kundër korrupsionit.

## Të drejtat themelore

- Në pajtim me Nenin 6 nga Marrëveshja për Bashkimin Evropian dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së drejtësisë së BE-së, Bashkimi respekton të drejtat themelore të cilat janë të garantuara me **Kartën për të drejtat themelore të BE-së**. Garantimi dhe avancimi i të drejtave themelore është parim themelor i të drejtës së Bashkimit Evropian dhe njëkohësisht është rezultat nga traditat e përbashkëta kushtetuese të vendeve anëtare. Të gjitha parimet janë të obligueshme për institucionet në kryerjen e detyrave të tyre edhe për vendet anëtare në zbatimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (Neni 51 nga Karta për të drejtat themelore të BE-së).
- Mbrojtja e të drejtave themelore e cila i mbulon të gjitha të drejtat e përfshira me Kartën.
- Në negociimet për Kapitullin 23 shqyrtohen këto **të drejta njerëzore**:
  - dinjiteti njerëzor;
  - e drejta për jetë dhe integritet të personalitetit;
  - ndalesa e torturës dhe trajtimit dhe dënimit johuman dhe poshtëruës;
  - ndalesa për robëri, skllavëria dhe puna me forcë dhe e detyruar;
  - respektimi i jetës private dhe komunikimeve familjare;
  - e drejta për martesë dhe e drejta e themelimit të familjes;
  - liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë;

<sup>1</sup> Aktet më të rëndësishme të BE-së janë: Konventa për mbrojtjen e interesave financiare të bashkësisë Evropiane nga viti 1995, Konventa për luftë kundër korrupsionit në të cilën janë të përfshirë persona zyrtarë të BE-së apo të vendeve anëtare që nga viti 1997 janë të bazuara në Nenin K.3(2, c) nga Marrëveshja për Bashkimin Evropian dhe Vendimin kornizë nga viti 2003 për parandalim të korrupsionit në sektorin privat.

- liria e tubimit dhe grupimit, duke përfshirë lirinë e formimit të partisë politike dhe themelimit të sindikatave;
- raporti kundrejt personave të cenuar socialisht dhe personat me nevoja të veçanta dhe parimi i mos diskriminimit;
- liria e shprehjes dhe pluralizmi në media; e drejta e arsimimit;
- e drejta në pronësi;
- barazia gjinore dhe të drejtat e grave, e të fëmijës.



Aspekte të caktuara të këtyre të drejtave, si dhe të drejtat tjera të garantuara me Kartën shqyrtohen gjatë aderimit edhe në kapitujt tjerë.

- Shteti i cili po aderohet duhet të sigurojë **masat mbrojtëse procedurale**: liria dhe siguria si dhe e drejta për gjykim të drejtë. Jashtëzakonisht e rëndësishme në këtë drejtim është praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, në veçanti në kuptimin e kufizimit të paraburgimit.

Bashkimi Evropian me Marrëveshjen e Lisbonës, për herë të parë në historinë e saj, morri kompetencën për të miratuar rregulla minimale në formë të direktivave të cilat mund t'u referohen të "drejtave të personave në procedurë penale" si dhe "pranim reciprok të provave", kështu që veç më janë sjellë më shumë direktiva.

- Në kuadër të Kapitullit 23 shqyrtohet edhe **respektimi dhe mbrojtja e pakicave dhe e të drejtave kulturore**, në bazë të dokumenteve ndërkombëtare si dhe dispozitave kushtetuese të shteteve candidate. Vëmendje e veçantë i kushtohet integritit të Romëve.
- Lëndë e shqyrtimit në procesin aderues janë edhe **masat për parandalim dhe luftë kundër racizmit dhe ksenofobisë**.
- Bashkimi Evropian, gjithashtu, e garanton edhe jetën private dhe **mbrojtjen e të dhënave personale** në pajtim me direktivat e sjella.<sup>2</sup> Çdo shtet anëtar i BE-së duhet të ketë trup të pavarur rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Bashkimi Evropian themeloi **Agjencinë për të drejtat themelore**, në të cilën shtetet candidate mund të kenë status të mbikëqyrësit.

2 Direktiva e BE-së 95/46/EK e Parlamentit Evropian dhe Këshilli për mbrojtjen e qytetarëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lirisë së lëvizjes së këtyre të dhënave, Vendimi kornizë 2008/977/PVR për mbrojtjen gjatë përpunimit të të dhënave personale në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në materien penale dhe Direktiva 2002/58/EK për përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjes së privacisë në sektorin e telekomunikimeve.

## Si vëzhgon dhe vlerëson Unioni Evropian?

- Komisioni Evropian në mënyrë të rregullt dhe sistematike e mbikëqyr përparimin e shtetit kandidat në kapitullin 23- përmes institucioneve të veta, informatave të marra nga shteti kandidat, nga organizatat ndërkombëtare si dhe nga sektori civil. Raportet e rregullta vjetore të Komisionit evropian përmbajnë kapitull të veçantë për Kapitullin 23 në të cilin jepen vlerësime për gjendjet si dhe rekomandime. Notat për këtë kapitull janë kyçe për përparimin e mëtuftëshëm të shtetit në procesin e integritimit evropian.
- Në bazë të raporteve, Këshilli i BE-së për punë të përgjithshme sjell konkluzione (më së shpeshti në dhjetor). Në raste të jashtëzakonshme Këshilli i BE-së ka dëgjim dhe më shpesh, ndërsa Komisioni evropian mund të përgatis edhe raporte të veçanta.<sup>3</sup>

Në vendosjen e standardeve për vlerësimin e gjendjes, institucionet e BE-së mbështeten në institucionet dhe trupat të cilat janë të krijuara nën mbrojtjen e Këshillit të Evropës, siç janë:

- *Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ)*: Gjykatë ndërkombëtare deri tek e cila qytetarët e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës mund të dorëzojnë padi kundrejt shtetit për shkeljen e neneve të konventës pas kalimit të të gjitha mundësive kombëtare juridike për mbrojtjen e të drejtave. Është krijuar jurisprudencë e pasur, e cila është burim i kriterëve për anëtarësim të kapitullit 23;
- *Komisioni i Venedikut*, i cili siguron ndihmë juridike për vendet anëtare në tre fusha: a) institucionet demokratike dhe të drejtat fundamentale; b) e drejta kushtetuese dhe e thjeshtë; c) zgjedhje, referendume dhe parti politike;
- *Grupi i shteteve kundër Korrupsionit (GREKO)*, i cili punon në përmirësimin e kapacitetit të vendeve anëtare për luftë kundër korrupsionit përmes monitorimit të harmonizimit të tyre me standardet kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës përmes një procesi dinamik të vlerësimit të dyanshëm.
- *Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit apo dënimit jonjerëzor apo poshtëruar (KPT)* ka vendosur sistem të mbikëqyrjes, përmes vizitave të menjëhershme të burgjeve dhe institucioneve të tjera për persona të cilëve u është kufizuar liria dhe dorëzon raporte të rregullta, me rekomandime.
- *Këshilli konsultues i gjykatësve evropian (KKGJE)*: trup këshillëdhënës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencën e gjykatësve.

3 Siç është rasti me raportin e fundit për Republikën e Maqedonisë nga një grup ekspertësh

- Komisioni evropian për efikasitet të drejtësisë, si trup për avancimin e efikasitetit dhe funksionimit të drejtësisë në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës
- dhe trupa të tjerë.

## Gjendjet në Kapitullin 23 në Republikën e Maqedonisë

- Për fat të keq, viteve të fundit vërehet një kthim mbrapa i Republikës së Maqedonisë në plotësimin e kritereve për anëtarësim në Kapitullin 23.
- Në Konkluzionet e Strategjisë për zgjerim për Republikën e Maqedonisë nga viti 2014, e cila sublimon konstatimet nga Raporti i KE-së është konstatuar:

*“Është serioz shqetësimi për politizimin në rritje të institucioneve shtetërore dhe kontrollit të qeverisë mbi mediat, duke i përfshirë në kontekstin e zgjedhjeve, sipas raporteve të OSBE/ODIHR. Gjithnjë e më shumë po dëmtohet besimi në institucionet shtetërore. Rritet shqetësimi për drejtësinë selektive. Situata e lirisë së mediave vazhdon të përkeqësohet...”*

- Në Rekomandimet e grupit të ekspertëve të lartë të KE-së, nga qershori 2015 janë të konstatuara mangësi të dukshme në pesë sfera: përcjellja e komunikacioneve, gjyqësia dhe prokuroria, mbikëqyrja e jashtme nga trupa të pavarur, zgjedhje dhe media. Në to, mes tjerash, është konstatuar:

*...“Skandali i përgjimit zbuloi shkëlqen masive të të drejtave themelore, duke e përfshirë edhe të drejtën e pjesëmarrjes në jetën publike dhe në votime, të drejtën e qasjes së barabartë drejt shërbimeve publike, të drejtën e privacisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të drejtën e gjyqësorit të pavarur dhe të paanshëm”...*

*...“Informatat e zbuluara së fundi tregojnë raste serioze të korrupsionit politik në nivele dhe mënyra të ndryshme”...*

*...“Kriza e mediave ua merr gazetarëve aftësinë për të vepruar në mënyrë profesionale dhe pa frikë. Pronarët e mediave dhe agjencitë private reklamuese rrezikojnë të hakmerren nga forcat politike nëse nuk tregojnë përkrahje për agjendën e tyre”...*


# Çfarë mund të bëjnë organizatat civile?

- Organizatat civile mund të realizojnë një ndikim real në përfundimin e demokracisë dhe sundimit të së drejtës në kontekstin e aderimit në BE, përmes:
  - përcjelljes sistematike të sferave dhe evaluimit të politikave të realizuara;
  - dhënies së rekomandimeve dhe propozimeve;
  - mobilizimin e palëve të prekura;
  - informimin e opinionit dhe angazhimin e qytetarëve për të realizuar të drejtat e tyre;
  - rrjetëzimin për të vepruar bashkërisht;
  - forma të tjera të veprimit.

- **RRJETI 23** përbëhet nga asociacione të qytetarëve të cilat në aktivitetet e tyre të rregullta i përcjellin dhe vlerësojnë politikën nga Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe i përfaqësojnë qëndrimet dhe propozimet e tyre në këto sfera para autoriteteve publike.

Përmes aktiviteteve të organizatave dhe të Rrjetit synohet nxitja e debatit publik në Republikën e Maqedonisë për çështjet nga sfera e gjyqësisë dhe të drejtave themelore të përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE, të sigurohet ndikimi mbi autoritetet publike dhe opinionin më i gjerë, përmes hulumtimit dhe përfaqësimit të bazuar mbi prova si dhe të mundësohet që qytetarët të kenë fjalën e tyre në çështjet kyçe të demokracisë dhe sundimit të së drejtës.


- **MERC 23** [www.merc.org.mk](http://www.merc.org.mk) kështu ueb-vegël, e cila përfaqëson qendër resursi për aderimin në BE në Kapitullin 23. Është bazë e të dhënave e cila mundëson kategorizimin, referencimin e tërthortë dhe përfaqësimin strukturor të dokumentacionit ekzistues në vend dhe Bashkimin Evropian për sferat nga Kapitulli 23 - Gjyqësori, anti-korrupsioni dhe të drejtat themelore.



Институт  
за  
европска  
политика.  
Скопје



ЦЕНТАР ЗА  
УПРАВУВАЊЕ СО  
ПРОМЕНИ



Ky botim u mundësua me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit Rrjeti 23 i cili është zbatuar nga Instituti për Politika Evropiane; Qendrës për menaxhim me ndryshime dhe Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut. Përbajtja në këtë publikim janë mendime të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti është përkrahur financiarisht nga Mbretëria e Holandës.